

Programi Zhvillimor 2020-2024



**Fakulteti i
Edukimit/
Universiteti i
Prishtinës**

Blerim Saqipi, PhD
Korrik, 2020

Përmbajtja

I. Hyrje	2
1. Parimet bazë të kulturës menaxheriale në vitet në vijim.....	2
2. Analizë e shkurtër e kontekstit.....	2
Sistemi i zhvillimit të mësimdhënësve në Kosovë.....	2
Realiteti i mësimdhënies dhe mësimxënies në shkollë	3
II. Veprimet për zhvillimin e Fakultetit të Edukimit.....	5
1. Objektivat zhvillimore	5
2. Filozofia e ndryshimit dhe qasja implementuese	5
3. Aktivitete kryesore sipas fushave për periudhën 4 vjeçare:	7
Zhvillimi i praktikave menaxheriale	7
Rritja e efektshmërisë së shërbimeve administrative	9
Sistemi i sigurimit të cilësisë	10
Zhvillimi dhe implementimi i programeve	11
Mësimdhënia dhe mësimxënia.....	12
Praktika e mësimdhënies për studentët	14
Zhvillimi i shkencës	14
Bashkëpunimi ndërkombetar	17
Lidhja me mjedisin dhe kontributi në sistem të arsimit	18
III. Aranzhimi i implementimit.....	19
Shtojca: Struktura organizative e implementimit të programit zhvillimor	20

I. Hyrje

Në këtë dokument janë paraqitur orientimet programore që përcaktojnë kahjen e zhvillimit të Fakultetit të Edukimit dhe që në ndërkohë do të shërbejnë si bazë për zhvillimin e Planit Strategjik të Zhvillimit të Fakultetit të Edukimit përmes qasjes konsultative dhe një procesi gjithëpërfshirës. Hartimi i Planit Strategjik do të inicohet në tetor 2020 dhe do të përfshijë edhe hartimin e vizionit dhe misionit për fakultetin. I tërë personeli akademik dhe administrativ do të përfshihet në proces ndërsa do të ketë edhe përfshirje të palëve të jashtme me interes si MASH, DKA, shkollat.

Ky dokument është strukturuar në këto nivele: parimet menaxheriale, konteskti i funksionimit, objektivat zhvillimore, aktivitetet prioritare për periudhën 4 vjeçare dhe profili i ekipit implementues. Disa nga këto aktivitete janë të natyrës zhvillimore dhe do të duhet të vazhdojnë nga këndvështrimi afatgjatë, megjithatë në procesin e planifikimit të detajuar për vitet vijuese do të precizohen caqet dhe do të shoqërohen me indikatorë të matshëm për këtë periudhë.

1. Parimet bazë të kulturës menaxheriale në vitet në vijim

Menaxhimi dhe udhëheqja në Fakultetin e Edukimit do të bazohet në disa parime bazë:

- Fokusi në mobilizim drejt vizionit të dakorduar të fakultetit
- Korrektësia në raportet hierarkike dhe kolegjinale
- Udhëheqje përmes modelimit
- Gjithëpërfshirja e personelit në proceset zhvillimore dhe vendimmarrje
- Zhvillimi i kolegjalitetit bashkëpunës dhe kulturës organizative të orientuar në ndryshim
- Transparenca në vendimmarrje dhe në menaxhim
- Vendimmarrja e bazuar në dëshmi (Ang: evidence-based decision making).

2. Analizë e shkurtër e kontekstit

Sistemi i zhvillimit të mësimdhënësve në Kosovë

Sistemi i aftësisë të mësimdhënësve në Kosovë ka kaluar nëpër një periudhë të ndryshimeve të vazhdueshme strukturore në dy dekadat e fundit. Krahas tendencës së universitarizimit të shkollimit të mësimdhënësve dhe me lansimin e procesit të Bolonjës u ngrit nevoja që programet që përgatisin mësimdhënës të avancohen nga kualifikimi dy vjeçar i Shkollave të Larta Pedagogjike (SHLP) në kualifikim bachelor. Tendencë e ngritjes së kërkesave për kualifikim si mjet për rritjen e cilësisë vazhdoi të jetë një shabllon i reformës edhe në dekadën e fundit. Në njërin anë, qeveria vendosi që programet që përgatisin mësimdhënës në ciklin lëndor të përfundojnë me gradën master, ndërsa në anën tjetër në vitin 2012 përmes një vendimi të ministrisë së arsimit u caktua edhe standardi i kualifikimit pedagogjik dhe praktik të të gjithë

mësimdhënësve të rinj. Kjo gjë në vitin 2017 u formalizua edhe në Udhëzimin Administrativ për licencimin e mësimdhënësve dhe u reflektua edhe në Kornizën Strategjike të Zhvillimit të Mësimdhënësve në vitin 2017. Ana pozitive e këtyre zhvillimeve është ngritja e vetëdijes në sistem të arsimit që përgatitja e mësimdhënësve përveç anës akademike duhet t'i kushtojë rëndësi të njëjtë edhe anës pedagogjike dhe praktike (përvojës domethënëse në shkollë).

Fakulteti i Edukimit është përballuar me sfidën e sigurimit të kuadrove të profileve që kërkonin ndryshimet e vazhdueshme programore. Universiteti i Prishtinës nuk ka ofruar mundësi deri tani që të realizohen studime të doktoratës në fushën e didaktikës lëndore dhe kjo ka qenë një nga sfidat kryesore të funksionimit të mirëfillt të sistemit të shkollimit të mësimdhënësve të rinj. Po ashtu, ka pasur mungesë edhe të studimeve të fushës së edukimit të përgjithshëm në nivel të doktoratës në Kosovë. Për më shumë, ofrimi i programeve në fusha të ndryshme të specializimit lëndor dhe fushës së përgjithshme të arsimit kërkon edhe nevojën e zhvillimit të asaj fushe si fushë hulumtimi përveç mësimdhënies në atë fushë. Andaj, në realitetin e tanishëm, sfidë në vete është përcjellja e trendeve nga personeli akademik në zhvillimet që ndodhin në shkencën e edukimit dhe standardet e profesionit të mësuesisë në realitetin post-modern, ndërsa realiteti i tanishëm në aktivitetin shkencor (publikime, përcjellja e konferencave shkencore etj) duhet të ndryshohet duke synuar thellimin në studimin e arsimit më shumë sesa fushës së caktuar akademike. E gjithë kjo duhet të vendoset në kontekst të zhvillimeve sociale e politike në Kosovë, rrethana në të cilat Kosova mëton të përcjellë standardet e arsimit dhe mësuesisë në Evropë (Referenca për profilin e mësuesit në nivel Evropian që Kosova duhet të përcjellë krahas politikave vendore:

https://ec.europa.eu/assets/eac/education/experts-groups/2011-2013/teacher/teachercomp_en.pdf)

Një element tjetër i kontekstit të funksionimit të Fakultetit të Edukimit është edhe realiteti që në 10 vitet e fundit nuk është vërejtur rritje e personelit në marrëdhënie të rregullt pune (trendi ka qenë të avancohen asistentët në vend të atyre që pensionohen). Proporcioni personel-studentë në fakultet mbetet ende sfidë dhe duke ditur numrin e madh të programeve dhe numrin e madh të studentëve, kjo gjë e ngarkon funksionimin e mirëfillt të fakultetit dhe sfidon iniciativat për reforma më thelbësore në fakultet duke pamundësuar mbulimin adekuat të programeve me mësimdhënës të profilit të caktuar dhe duke kufizuar kohën e personelit për hulumtime shkencore. Për më shumë, një situatë e tillë ka shkaktuar edhe ngarkesë të shtuar të personelit në mentorimin e temave të masterit, në mësimdhënie, etj.

Realiteti i mësimdhënies dhe mësimxënies në shkollë

Nën anën tjetër, funksionimi i sistemit të përgatitjes së mësimdhënësve duhet të shihet edhe nga perspektiva e realitetit në sistemin shkollor në Kosovë. Cilësia e mësimdhënies në Kosovë është konfirmuar tashmë që është e dobët dhe dy vlerësimet ndërkombëtare PISA (2015 dhe 2018) ka renditur nxënësit e Kosovës në fund të tabelës. Edhe pse ka shumë faktorë që ndërlidhen më mësimin apo mosmësimin e nxënësve, efekti që mësimdhënësi ka në të mësuarit e nxënësve është megjithatë esencial. Më shumë sesa rangimi në fund të tabelës, performanca e nxënësve të

Kosovës në vlerësimin PISA tregon se mësimdhënia në Kosovë është e orientuar në riprodhim të informatës e jo përdorim të saj në praktikë, ndërsa ngriten edhe shumë brenga të tjera rreth mungesës së praktikave të të mësuarit eksplorues, mësimdhënies së diferencuar etj. Edhe Indeksi i Kapitalit Njerëzor i Bankës Botërore (2019) ka treguar që nxënësit e Kosovës për 12.8 vite shkollim që bëjnë deri sa arrijnë moshën 18 mësojnë sa 7.7 vite që nënkupton se ekziston një zbrastirë e të mësuarit prej 5.1 vite e që në vetëvete duhet të jetë alarm për funksionimin e shkollës dhe rolin e mësimdhënësit në këtë kontekst.

Për fund, numri i nxënësve në Kosovë është në rënie e sipër (rreth 1000 nxënës më pak secilin vit), ndërsa numri i mësimdhënësve të kualifikuar në treg ka shënuar ngritje të vazhdueshme (janë edhe 4 fakultete të tjera të edukimit me kuota të larta të studentëve në programe të caktuara). Kjo e vendos Fakultetin e Edukimit para një situatë që të orientohet në caktimin e një standardi të ri të përgatitjes së mësimdhënësve në vend, dhe në marrjen e rolit prijës si institucioni elitar dhe kontribues i zhvillimit të profesionit të mësuesisë në Kosovë.

II. Veprimet për zhvillimin e Fakultetit të Edukimit

1. Objektivat zhvillimore

Zhvillimi i fakultetit do të drejtohet nga një numër objektivash zhvillimore që synojnë avancimin nga gjendja ekzistuese drejt asaj të dëshirueshme. Gjatë procesit të hartimit të planit strategjik të zhvillimit të fakultetit, përmes qasjes konsultative do të hartohet deklarata e vizionit dhe misionit të fakultetit. Në parim, vizioni do të reflektojë nevojën e aftësimit të mësimdhënësve cilësor për t'u përballur me sfidat e profesionit dhe realitetin në klasë dhe shoqëri si dhe avancimin e hulumtimeve shkencore në fushën e edukimit. Ndërsa, përmes deklaratës së misionit do të synohet zgjerimi i fushëveprimit drejt ofrimit të zhvillimit profesional dhe kontributit në sistem të arsimit krahas kryerjes së veprimtarive bazike në mësimdhënie dhe hulumtim. Objektivat zhvillimore të caktuara si orientim i këtij programi zhvillimor janë:

- a. Lidhja e përgatitjes së mësimdhënësve me reformën shkollore dhe kërkesat për profesionalizëm të mësimdhënësve;
- b. Përgatitja e cilësore e mësimdhënësve të rinj e fokusuar në zhvillimin e të kuptuarit, shkathtësive dhe vlerave që konsiderohen të domosdoshme për mësimdhënësin e shekullit të tanishëm;
- c. Qasja koherente dhe programore dhe jo kurse te izoluara në hartimin dhe implementimin e programeve studimore;
- d. Krijimi i kulturës organizative zhvillimore dhe të orientuar në ndryshim që mundëson praktika cilësore në implementimin e programeve;
- e. Zhvillimi i kapaciteteve profesionale të personalit akademik për të përcjellë trendet në hulumtime dhe mësimdhënie në fushën e edukimit dhe për të implementuar mësimdhënie cilësore;
- f. Fakulteti i Edukimit udhëheqës në zhvillimet në sektorin e përgatitjes së mësimdhënësve dhe kontribues aktiv në cilësinë e sistemit të arsimit parauniversitar.

2. Filozofia e ndryshimit dhe qasja implementuese

Ndryshimi organizativ do të vendoset si fokus i reformës duke u nisur nga parimi që të diplomuarit do të jenë cilësor vetëm atëherë kur përvoja me profesorë të ndryshëm dhe shërbimet administrative do të jenë e cilësisë së duhur. Dhe, në anën tjetër, institucioni do të jetë cilësor kur formësohet kultura organizative që synon zhvillimin dhe cilësinë, ndërsa ndryshimi i menaxhmenteve nuk do të rrezikonte ndryshime esenciale në mënyrën e funksionimit. Pra, synim

i këtij programi do të jetë zhvillimi i një kulture të tillë që do të jetë edhe baza e qëndrueshme e zhvillimit afatgjatë të Fakultetit të Edukimit si institucion elitar në Kosovë për përgatitjen e mësimdhënësve.

Implementimi i reformës në fakultet të edukimit do të adresohet duke marrë parasysh kontekstin aktual në dimensionet e (i) cilësisë së mësimdhënies dhe hulumtimit të personelit akademik, (ii) cilësisë së shërbimeve administrative, (iii) cilësisë së praktikave menaxheriale, (iv) cilësisë së studentëve që tërheqim dhe pranojmë në fakultet, (v) cilësisë së përvojës së studentëve gjatë praktikës në shkollë. E gjithë kjo duhet të adresohet nga perspektiva e standardeve të profesionit të mësuesisë dhe llojit të mësimdhënësve që duam dhe duhet të dërgojmë në shkollë.

Pastaj, duhet të merret parasysh edhe fakti se pse shpesh reformat dështojnë shumë shpejt pasi të inicohen apo përfundojnë në ndryshime sipërfaqësore. Kjo ndodhë kur fokusi vendoset në ndryshimin e aktivitetit duke i bërë gjërat në mënyrën që nuk janë bërë deri tani. Kjo mund të bëhet kur pyetja që kemi para nesh është: A po i bëjmë gjërat mirë? Ndërsa, ndryshimi i kahjes së aktiviteteve do të ishte një gjë lehtë e realizueshme, kjo nuk do të sillte rezultatet në rrethanat që kërkojnë ndryshime më thelbësore. Andaj, kërkohet që intervenimi të vendoset në një nivel më të lartë duke synuar të marrim përgjigjen ndaj pyetjes: A jemi duke i bërë gjërat e duhura? Kjo do të kërkonte pra nevojën që të shqyrtojmë supozimet që ne mund të kemi për kapacitetet profesionale dhe nivelin e intervencimit që planifikojmë për të ndryshuar gjendjen aktuale.

Pra, shpesh kërkohet që ne të ekzaminojmë problematikën e ndryshimit më gjërë në kontekstin në të cilin funksionojmë (dhe jo vetëm të vazhdojmë të ndryshojmë aktivitetet si ndryshimi i lëndëve në programe, modifikimi i sillabuseve etj). Brenda kontekstit, në fushën e funksionimit të fakulteteve të edukimit, do të ishte me interes të ekzaminohen edhe aspektet si p.sh: kush janë profesorët dhe asistentët që mbajnë mësim? Cili është potenciali dhe motivimi i studentëve që tërheqim në fushën e mësuesisë? Në rast se problemi i reformës qëndron në nivelin e tillë të elementeve kontekstuale dhe më përmbajtësore, çdo reformë në nivelin e aktiviteteve si p.sh të ndryshojmë programet, të ndryshojmë një sillabus apo të blejmë disa kompjuterë do të rezultonte në një reformë sipërfaqësore dhe jo ndryshim të qëndrueshëm. Edhe këto ndryshime do të jenë të nevojshme, por shpesh të pamjaftueshme.

Ky program zhvillimor synon të adresojë këtë kompleksitet të reformës arsimore dhe për më tej synon që në fazat e para të implementimit (në kohën e hartimit të planit strategjik) konteksti i funksionimit të Fakultetit të Edukimit të analizohet përmes një qasjeje më githëpërfshirëse dhe të përcaktohet modaliteti i duhur i zbatimit të reformës.

3. Aktivitete kryesore sipas fushave për periudhën 4 vjeçare:

Zhvillimi i praktikave menaxheriale

Zhvillimi i Planit Strategjik për Fakultetin e Edukimit: Në periudhën tetor-dhjetor 2020 do të zhvillohet Plani Strategjik për Zhvillimin e Fakultetit të Edukimit duke marrë për bazë edhe këtë program. Grupi punës i themeluar për këtë qëllim do të bëjë analizën e gjendjes aktuale dhe bashkë me Këshillin e Fakultetit do të hartojë Planin Zhvillimor që do të shërbejë si udhëzues jo vetëm për menaxhimin, por edhe zhvillimin afatgjatë të fakultetit. Plani do të bëhet publik për të gjitha palët dhe do të shërbejë edhe si mekanizëm për marrjen e donacioneve për zhvillim.

Rregullimi i funksionimit të punës në rast të vazhdimin të COVID-19: Në rast se gjendja e tanishme COVID-19 do të vazhdojë edhe në vitin e ri akademik dhe tutje, në kuadër të udhëzimeve dhe vendimeve të nivelit qendror, Fakulteti i Edukimit do të miratojë rregulloren e vet për mbajtjen e mësimin dhe funksionimin e administratës në rrethana të pandimsë COVID-19. Rregullorja do të parasheh edhe modifikimin e sillabuseve në pjesën e vlerësimit duke synuar vlerësimin përmes punimeve të shkruara dhe përmes testeve online, si dhe funksionimin e administratës duke paraparë edhe modelin e nënshkrimeve online të dokumenteve.

Ndarja e qartë e përgjegjësi midis të gjithë akterëve: Në formë të shkruar do të precizohen rolet dhe përgjegjësitë e secili akter duke u elaboruar precizimet që janë në dokumente ligjore, por edhe duke marrë parasysh nevojën për qartësimin procedural dhe administrativ. Me këtë rast, do të saktësohen roli dhe përgjegjësia e prodekanëve, shefave të departamentit, udhëheqësve të ekipeve hulumtuese (shih tek zhvillimi i shkencës), këshillit të fakultetit, komisionit të studimeve, këshillit të doktoratës etj. Ndarja e përgjegjësi bëhet në dimensionet e hartimit të programeve, planifikimit të angazhimeve, orarit të mësimin, hartimit të provimeve pranuese, monitorimit të implementimit të programeve dhe cilësisë së tyre. Në formë të shkruar të gjithë akterët do të kenë dokumentacionin.

Zhvillimi i politikave të reja: me qëllim të shmangjes së veprimit ‘ad hok’ dhe duke iu përshtatur situatave momentale dhe duke synuar promovimin e veprimeve korrekte dhe të qëndrueshme, do të zhvillohet një proces për identifikimin e sfidave kryesore me të cilat është përballë zhvillimi i fakultetit në vitet e fundit me qëllim të adresimit të tyre në situata të ngjashme në të ardhmen. Disa nga politikat që do të zhvillohen janë: Politika mbi prioritetimin e shpalljes së konkurseve për avancim në rastet kur nuk ka mundësi për të gjithë; Politika mbi ndarjen e orëve të mësimin/angazhimit; Politika mbi kufizimet/mundësitë që personeli të mbajë lëndë në fushat e përafërta me kualifikimin e tyre dhe në rastet kur nuk i ka ato në vendim; Politika mbi trajtimin e recenzioneve për zgjedhje dhe rizgjedhje në këshill të fakultetit (ndalimi i avancimeve jomeritore në këshill dhe jo procesimi i panevojshëm në senat të universitetit); Politika mbi shpalljen e konkurseve të reja dhe kriteri i grupimit/caktimit të lëndëve për konkurs; Politika mbi caktimin e mentorëve dhe komisioneve të temave master dhe doktoratë; Politika

mbi sigurimin e cilësisë (monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë) (shih seksionin për sigurimin e cilësisë), etj.

Zhvillimi i pakos administrative dhe menaxheriale: Menaxhimi dhe administrimi i mirë kërkon edhe mjetet menaxheriale. Në fakultet ekziston nevoja e hartimit të rregulloreve/udhëzuesve për veprime të ndryshme që do të lehtësojnë sjelljen e secilit në detyrë. Në formë të vendimeve do të hartohet disa rregullore/udhëzues: Kërkesa për ndihmë rreth teknologjisë informative (rregullimi i kompjuterit, rregullimi i SEMS, ndërhyrja në SEMS për printim, korrigjim të gabimeve etj); Veprimi dhe sjellja në situata emergjente për shembull në raste të termetit, zjarrit, vjedhjes etj; Kërkesa për udhëtime zyrtare dhe mobilitet të studentëve; Raportet pas vizitave akademike të stafit dhe studentëve dhe mirëmbajtja e të dhënave për raportim të rregullt në nivel fakulteti për nevoja vetanake, për univeristetin dhe palët e jashtme; Raportimi për projekte të ndryshme në baza të rregullta, qoftë këto projekte të mëdha apo projekte individuale që personeli angazhohet përmes ose në emër të fakultetit. Po ashtu, do të hartohen edhe protokole rreth kërkesës dhe modelit të procesverbalit për mbledhjet e këshillit, departamentit etj. Pakoja menaxheriale dhe administrative do të botohet në formë të manualit, do të botohet online dhe do të jetë në dispozicion për të gjithë stafin.

Sigurimi i kohës për aktivitete efektive: Dekanati do të caktojë dy gjysmë dita gjatë javës ku nuk do të ketë ligjërata dhe provime e të cilat shfrytëzohen për takime, seminare, mbrojtje të temave të diplomës etj.

Instrumentet për planifikim dhe menaxhim të informatave: Do të hartohen programe/instrumente për planifikimin e orareve të mësimit dhe provimeve në mënyrë të centralizuar dhe me kontribut nga departamentet dhe referentët, si dhe një program për menaxhimin e informatave për procesin e temave master (duke saktësuar datën e miratimit, datën e diskutimit publik, temën, mentorin, kohëzgjatjen etj). Programi për menaxhimin e informatave për tema master do të vendoset në funksion në nëntor 2020, ndërsa paralelisht do të vazhdojë puna për avancimin e tij në një sistem elektronik të menaxhimit të procesit të temave master duke përfshirë vlerësimin e dorëshkrimit, dhënien e komenteve, miratimin etj.

Përmirësimi i cilësisë së informatave dhe dizajnit të web faqes: Web faqja e fakultetit do të avancohet me informata që janë më lehtë të qasshme, më tërheqëse për audiencën dhe më gjithëpërfshirëse. Web faqja do të plotësohet në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze në baza të vazhdueshme.

Planifikimin i buxhetit zhvillimor: Procesi i planifikimit të buxhetit të fakulteti do të jetë transparent dhe me përfshirje të departamenteve. Buxheti, përkundër kufizimeve, do të reflektojë qasjen zhvillimore dhe mbështetjen e implementimit të Planit Strategjik të Fakultetit.

Racionalizmi i shfrytëzimit të hapsirës së fakultetit: Do të bëhet një analizë e racionalitetit të shfrytëzimit të objektit të fakultetit duke përfshirë shfrytëzimin e sallave të mësimit, zyreve dhe hapësirave të tjera. Në bazë të sajë do të hartohet një dinamike e implementimit të ndryshimeve

të nevojshme për shfrytëzim sa më racional dhe të arsyeshëm të hapësirave në fakultet. Në këtë kontekst, do të racionalizohet edhe shfrytëzimi i oborrit dhe parkingjeve duke caktuar vende të caktuara parkingu për Emergjencën dhe dy vende për parkingun për veturat që shërbejnë personat me nevoja të vecanta. Të tjerët trajtohen të barabartë dhe nuk do të lejohet shfrytëzimi i parkingut për personat që nuk punojnë në fakultet.

Java orientuese për studentët e rinj: Në fillim të secilit vit akademik do të planifikohet java orientuese për studentët e rinj; Studentët do të njihen me programin e studimeve, rregullat e fakultetit, qasjen në bibliotekë, procedurat e bashkëpunimit me zyren e IT-s dhe shërbimeve për studentë. Do të përgatitet pakoja e materialeve për studentë që t'u shpërndahet që në javën e parë.

Komunikimi i brendshëm dhe i jashtëm: Do të synohet një balans midis komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm. Komunikimi me publikun do të jetë shumë me interes dhe përveç pjesëmarrjes së përfaqësuesve të fakultetit në debatet dhe forumet e ndryshme asimore, do të planifikohet edhe organizimi i konferencave dhe sympoziumeve të ndryshme me qëllim të komunikimit me publikun e gjerë, ndërsa komunikimi i formave të tjera do të bëhet edhe përmes publikimit të broshurave të ndryshme dhe përmes rrjeteve sociale si facebook dhe twitter në të cilat fakulteti do të ketë një qasje më aktive. Fakulteti do të ketë një shenjë identifikuese për vetën si formë e logos dhe motos e që do të reflektohet në materiale promovuese, por edhe do të reflektohet fizikisht në objekt dhe hapësirat e fakultetit (renovimi i pjesës së jashtme të objektit duke reflektuar këtë identitet).

Hartimi i raporteve të rregullta për punën dhe zhvillimet në fakultet: Do të instalohet kultura e hartimit të raporteve të rregullta dy herë në vit për punën dhe zhvillimet në fakultet me qëllim edhe të monitorimit të implementimit të strategjisë së zhvillimit të fakultetit. Raportet do të kenë shifra, fakte dhe përshkrim të implementimit të veprimtarisë së fakultetit.

Rritja e efektshmërisë së shërbimeve administrative

Ndryshimet e shpeshta programore kanë sjellë në vete sfida të natyrave të ndryshme edhe administrative, andaj mungesa e resurseve të duhura për të mbështetur reformat e synuara ka qenë vështirësi e theksuar për të udhëheqë administratën e fakultetit drejt qasjes që të funksionojë si shërbim për cilësi e jo si qëllim në vetëvete.

Në raport me zhvillimet të viteve të fundit në fakultet (fokusi në programe master krahas studimeve bachelor) dhe vizionit për zhvillimin e mëtejshëm në vitet në vijim, do të bëhet në muajt e parë një analizë gjithëpërfshirëse e shërbimeve administrative për studentët dhe personelin. Do të identifikohen vështirësitë dhe hallkat e funksionimit joefikas për të realizuar ndryshimet e duhura.

Së pari, do të bëhet sistemi i zyrtarëve të shërbimit të studentëve në proporcion me volumin e punës dhe numrin e studentëve që shërbejnë. Ky sistemim do të bëhet në raport me strukturimin e departamenteve dhe detyrave të prodekanëve.

Së dyti, do të hartohet një protokol (që do të integrohet në pakon menaxheriale dhe administrative) lidhur me procesin e komunikimit, llogaridhënien dhe komunikimin midis akterëve të ndryshëm. Shembull të këtyre protokoleve janë detajimi i procesit të temave të masterit (p.sh si dhe tek kush e dorëzon studenti projektin; si e merr informatën për miratim/refuzim dhe kometet eventuale, si procesohet projekti në hapat tutje, si bëhet nënshkrimi dhe protokolimi, si menaxhohet diskutimi publik dhe si realizohet procesi i mbrojtjes). Po ashtu, shembuj të tjerë janë procesi i dorëzimit të fletëparaqitjeve fizike nga profesorët tek administrata, procesi i temave bachelor etj.

Të gjitha detajet e procesit të rrjedhës së informatës dhe formularët e caktuar do të shtjellohen në këto protokole, duke përfshirë edhe procesin e identifikimit të mosrealizimit të detyrave qoftë nga administrata, qoftë nga stafi akademik apo menaxherial.

Sistemi i sigurimit të cilësisë

Ndërtimi i sistemit të sigurimit të cilësisë: në kuadër të dispozitave statutare, rregullores për sigurimin e cilësisë në UP, si dhe kërkesave të Agjencisë së Akreditimit, Fakulteti i Edukimit do të miratojë politikën dhe mekanizimin për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Ky mekanizëm i sigurimit të cilësisë do të shërbejë përtej kërkesave të sistemit të akreditimit duke synuar ndërtimin e kulturës së brendshme të zhvillimit. Në kuadër të kësaj politike, do të bëhet mbledhja e të dhënave për cilësinë e mësimdhënies, cilësinë e praktikës në shkollë, relevancën e hulumtimeve shkencore, shërbimet e studentëve etj. Në bazë të të dhënave do të hartohen raporte të ndryshme për vendimmarrje, zhvillim dhe për informim të të gjithë stafit. Raportet nga vlerësimi i mësimdhënies do të diskutohen me stafin përkatës dhe, sipas nevojës, edhe me grupet e studentëve në prani të personelit akademik në fjalë, me qëllim të vetëm përmirësimit e gjendjes aktuale dhe vetëdijesimit të studentëve që mund të jenë akterë në cilësinë e studimeve. Vlerësimet e tilla do të bëhen në baza të rregullta. Ndërsa si inovacion, brenda kësaj politike do të planifikohet edhe një kornizë për analizën e programeve dhe sillabuseve për të parë nëse kurset dhe programet janë në harmoni me profilin e kompetencave për mësues në nivel vendi dhe në nivel Evropian (profil që përfshinë: të kuptuarit dhe njohuritë, shkathhtësitë e vlerat dhe qëndrimet).

Fokus i veçantë brenda sistemit të sigurimit të cilësisë do të jetë monitorimi i realizimit të sillabuseve dhe kjo do të bëhet në komunikim me studentët në njërën anë dhe përmes takimeve e punëtorive të ndryshme të grupeve të personelit për të bërë shqyrtimin e realizimit të tyre, sfidave që janë përballë dhe ndryshimeve që do të bëhen në semestrin vijues.

Në bazë të analizave dhe të dhënave të mbledhura, fakulteti harton planin e përmirësimit për periudhën vijuese e cila shërben për qëllime zhvillimi dhe si demonstrim ndaj procesit të

akreditimit për përkushtimin institucional për të ndërtuar mekanizmat e brendshëm të sigurimit të cilësisë. Sistemi do të jetë permanent dhe implementohet në baza të rregullta, ndërsa raportet e përmirësimit hartohen për periudhën 3 vjeçare.

Zhvillimi dhe implementimi i programeve

1. Rritja e standardit të pranimit të studentëve në program

Në sistemin e aftësisë të mësimdhënësve në Kosovë ka munguar debati rreth tërheqjes së kandidatëve të mirë profesionin e mësuesisë si hap kyç në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënësve. Përderisa me përmirësimin e kushteve të punës në shkollë (përmirësimi i pagave të mësimdhënësve) ka shkaktuar rritjen e interesimit të kandidatëve me sukses të mirë nga shkollimi paraprak për t'u bërë mësimdhënës duhet gjetur rrugë të tjera për të ngritur bazën minimale të profesionalizimit të mësimdhënësve të rinj. Janë dy masa që duhet ndërmarrë në lidhje me këtë çështje!

Së pari, Fakulteti i Edukimit do të promovojë më shumë programet e veta të studimit në publik (online dhe përmes formave të tjera). Përmes rrjeteve sociale fakulteti në muajin Maj dhe Qershor të secilit vit do të plasojë në publik material informativ rreth programeve që ofron, kriterëve për pranim dhe do të ofrojë udhëzime për përgatitje për provimet pranuese si dhe një përmbledhje të përmbajtjes programore që reflektohet në provime pranuese.

Së dyti, Fakulteti do të ndryshojë qasjen në pranimin e studentëve të rinj duke mos lënë në diskrecion të hartuesve të testeve pranuese caktimin e standardit. Për të adresuar këtë, fakulteti do të zhvillojë një tabelë të specifikave të testit pranues që do të udhëzojë hartuesit e testit në definimin e përmbajtjes së testit dhe në hartimin e tyre. Kjo tabelë e specifikave do të shërbejë edhe si udhërrëfyes për kandidatët që të përgatiten për provim pranues dhe do të bëhet publike bashkë me provimin e programeve (shih pikën më lartë).

2. Definimi i kuotave të pranimit sipas nevojave

Për vitet vijuese fakulteti do të bëjë një analizë të shpejtë të nevojave të tregut (konsulta me një mostër të DKA-ve për praktikantët e së kaluarës për konkurse dhe shqyrtimi i raporteve ekzistuese në MASHT) për të përcaktuar numrat e studentëve për programe. Kuotat do të përcaktohen në raport me nevojat dhe në raport me kapacitete ekzistuese në fakultet. Orientimi do të jetë të punohet drejt cilësisë dhe jo sasisë, sepse Kosovës i duhen mësimdhënës më të përgatitur dhe jo më shumë në numër.

3. Akreditimi dhe ri-akreditimi i programeve

Fokus i theksuar do të vendoset në akreditimin dhe riakreditimin e programeve ekzistuese bachelor dhe master si dhe në adresimin e rekomandimeve nga proceset paraprake të vlerësimit. Ndërsa, në të njëjtën kohë, fakulteti do të nisë përgatitjet që në periudhën tetor 2020 – shkurt 2021 të finalizohen përgatitjet për rikthimin e akreditimit të programit të doktoratës. Për këtë, do të punohet intensivisht në sigurimin e personelit të duhur për akreditim të programit dhe do të

rishikohet programi sipas nevojave dhe përvojës së deritanishme duke synuar hapjen e mundësisë për student të fushës së përgjithshme dhe profileve të ndryshme lëndore.

Fakulteti, përmes komisionit të studimeve dhe këshillit të fakultetit, do të analizojë ofertën e programeve dhe do të identifikojë zbrastësitat në programet e fushës së edukimit që ka Kosova duke marrë për bazë fakultetet e caktuara në Evropë dhe SHBA. Në kontekst afatmesëm do të identifikohet së paku një program i ri që fakulteti synon ta zhvillojë dhe do të hartohen projekte konkrete për realizimin e tij.

Në vitet vijuese, fakulteti do të shqyrtojë dhe konkretizojë mundësinë për të ofruar së paku një program rajonal si program i përbashkët me universitete të tjera në Evropë. Ky program do të ofrohet në gjuhën angleze dhe do të synojë grupet e studentëve në rajon. Iniciativa është ambicioze, por do të punohet që institucioni të orientohet në atë drejtim, ndërsa afati i realizimit do të caktohet pas analizës së detajuar të projektit dhe pas identifikimit të partneritetit.

Mësimdhënia dhe mësimnxënia

Mbajtja e mësimit: fokus të veçantë do të ketë monitorimi i mbajtjes së mësimit dhe realizimi i sillabuseve të publikuara. Kjo do të bëhet në formë të monitorimit të evidencave të mësimit dhe përmes anketimit të studentëve dhe bisedave në grupe rreth implementimit të sillabuseve dhe mbarëvajtjes së mësimit. Në këtë proces do të angazhohen prodekanët dhe shefat e departamenteve. Në rastet kur vërehen parregullsi të caktuara ato do të adresohen me profesorët/asistentët në fjalë. Në kuadër të implementimit të mësimit, do të bëhet shqyrtimi i rregullt i sillabuseve nga grupet e profesorëve dhe asistentëve që mbajnë lëndë të përafërta apo të njëjta dhe në prezencë edhe të shefave të departamenteve dhe prodekanëve.

Politikat kadrovike: do të bëhet analiza gjithëpërfshirëse e profilit të personelit (fusha dhe tema e studimeve të doktoratës, lëndët për të cilat është zgjedhur, lëndët që mban secili në realitet, përmbledhja e punimeve shkencore në revistat e indeksuara në Scopus dhe Web of Science). Po ashtu, do të bëhet edhe një analizë e mbulueshmërisë së programeve me personel duke marrë parasysh normën e personelit ekzistues dhe eventualisht mbinormën. Kjo do të ndihmojë edhe identifikimin e zbrastërave kadrovike dhe do të përdoret si pikë referimi për avancimet e brendshme dhe për hapjen e pozitive të reja.

Fuqizimi i fushave deficitare të studimit: përveç ofrimit të mundësive për zhvillim të personelit ekzistues, fakulteti do të angazhohet në rritjen e kapaciteteve në disa fusha që janë esenciale për funksionim të mirë të një fakulteti të edukimit. Disa prej këtyre fushave që ende duhet të zhvillohen në fakultet, duke shtuar kuadrot e përmes kësaj duke avancuar hulumtimin shkencor, janë: edukimi inkluziv, udhëheqja arsimore, metodat e hulumtimit, politikat kurrikulare dhe fushat e tjera që mund të dalin nga analizat e mëtejme. Kjo çështje do të adresohet përmes disa veprimeve. Në njërën anë do të identifikohen gjenerata të reja të studiuesve që kanë përfunduar studimet jashtë vendit dhe do të shikohen mundësitë e lidhjes së tyre me fakultetin (p.sh rreth 20 persona kanë përfunduar në vitet e fundit studimet Master në

fushën e edukimit në SHBA). Po ashtu, do të identifikohen edhe studiues të nivelit PhD dhe ata që kanë përfunduar PhD në fushat deficitare që të gjenden modalitetet e lidhjes së tyre me punën e fakultetit.

Në anën tjetër, do të identifikohet një grup i studiuesve të rinj që do të dërgohen në Universitetin e Lublanës për studime të nivelit PhD (programi që synohet të ofrohet partneritet mes UP/FEs, Universitetit të Lublanës dhe një Universiteti në SHBA) që do të implementohet në bashkëmentoring me profesorë nga fakulteti i edukimit në Prishtinë me qëllim të adresimit të fushave deficitare për fakultetet e edukimit në Kosovë.

Zhvillimi i kapaciteteve të personelit akademik: fakulteti do të sigurojë një program të formatit ‘post-doc’ në fushën e edukimit për personelin ekzistues akademik. Programi do të synojë avancimin e kapacitetit të personelit për hulumtim në edukim, publikim në fushën e edukimit, mësimdhënien cilësore në fakultet (mësimi i bazuar në probleme, mësimi i bazuar në projekte, të mësuarit aktiv e ndërveprues etj), të kuaptuarit e bazës teorike, filozofike dhe sociologjike të arsimit, etj. Po ashtu, programi do të synojë të zhvillojë kapacitetet e personelit në zhvillimin e didaktikës lëndore si një fushë kryesore në implementimin e programeve master të fushave lëndore. Një program i tillë do të implementohet nga universitetet evropiane dhe do të përgatitet në atë mënyrë që t’i përshtatet nevojave dhe sfidave aktuale që ka personeli akademik. Po ashtu, do të implementohen aktivitete drejt implementimit të vlerësimit të vazhdueshëm dhe reflektimit të standardit minimal të notës kaluese në kurset e ndryshme duke siguruar që studentët që përparojnë në program i plotësojnë kërkesat minimale dhe kanë potencial për plotësim të profilit të kërkuar të mësimdhënësit.

Promovimi i mësimdhënies cilësore në fakultet: do të identifikohen modalitete për të promovuar modele të mësimdhënies së mirë si p.sh incizime të aktivitetit të studentëve në programe të caktuara, shkëmbimit të përvojave mes kolegëve. Fokusi i zhvillimit të mësimdhënies cilësore (e që lidhet me aktivitetin e zhvillimit të kapaciteteve të personelit më lartë) do të reflektojë konceptet si: mësimi i bazuar në probleme, mësimi i bazuar në projekte, mësimdhënia e bazuar në hulumtim, të mësuarit aktiv e ndërveprues, mësimdhënia me nxënësin në qendër, etj. Në funksion të këtij qëllimi, do të vendoset procesi transparent dhe meritore i zgjedhjes së mësimdhënësit (profesorit dhe asistentit) të dalluar me qëllim të shpërndarjes së mirënjohjeve përmes një procesi të dakorduar dhe të njohur për të gjithë.

Implementimi i kurseve përmes qasjes ‘blended learning’: edhe pse situata e muajve të fundit e COVID-19 ka shtyrë fakultetin të fillojë praktikën e mësimi elektronik, në vitet në vijim do të punohet në identifikimin dhe realizimin e kurseve përmes konceptit ‘blended learning’ ku ligjëratat në fakultet do të plotësohen edhe me aktivitete përmes platformave online si google classroom, moodle, etj.

Cilësia e punimeve të diplomës: fakulteti do të adresojë standardin e daljes nga fakulteti dhe hyrjes në profesion. Për të realizuar këtë, fakulteti do të zhvillojë një proces për të diskutuar

standardin aktual të temave të diplomës në nivelin bachelor. Për diplomat Bachelor, do të përditësohet dhe publikohet manuali për tema të diplomës, ndërsa do të zhvillohet edhe udhëzuesi për shkrimin e punimeve të diplomës (Ang. Template) për të unifikuar shkrimin, citimin dhe organizimin e temave të diplomës. Një filtër i cilësisë së temave të diplomës do të vendoset pas qasjes konsultative në Këshillin e Fakultetit dhe do të formësohet si politikë formale e fakultetit. Krahas rritjes së standardit të temës së diplomës, do të punohet në drejtimin që studentët do të lidhin praktikën e fundit në shkollë me punimin e diplomës në nivel bachelor, e që duhet të ikë nga stili klasik i temave të diplomës drejt qasjes aplikative dhe të ndërlidhur ngushtë me implementimin e kurrikulës shkollore.

Funksionalizimi i bibliotekës dhe shfrytëzimi i resurseve mësimore: në kuadër të sistemimit dhe riorganizimit dhe plotësimit të stafit administrativ, funksionalizimi i bibliotekës do të jetë esencial. Përveç hapjes së bibliotekës për personelin dhe studentët, do të hartohet edhe katalogu elektronik i librave në dispozicion dhe do të vendoset procesi formal i shfrytëzimit të librave dhe materialeve të tjera prej bibliotekës nga studentët dhe personeli akademik.

Po ashtu, do të organizohet një material i shkurtër dhe praktik si udhëzues për studentë se si të përdoren burimet elektronike në të cilat ka qasje universiteti si p.sh ScienceDirect e po ashtu edhe ato që ka në dispozicion biblioteka kombëtare.

Praktika e mësimdhënies për studentët

Do të bëhet analiza e praktikave aktuale të implementimit të praktikës së studentëve në fakultet duke përfshirë edhe palët e ndryshme të interesit si drejtorët e shkollave, mësimdhënësit, studentët, profesorët mbikëqyrës). Po ashtu do të bëhet edhe studimi i modeleve të mira në Evropë për të dizajnuar një model më efikas për implementimin e praktikës së studentëve në shkollë. Si rezultat, do të miratohet një rregullore për implementimin e praktikës dhe do të ndryshohen dhe hartohen doracakë të duhur për të lehtësuar implementimin e kësaj reforme.

Disa prej ideve që do të diskutohen në këtë kontekst janë edhe mundësia e incizimit të orëve nga ana e studentëve dhe përdorimi i modeleve të orëve të incizuara në Kosovë dhe jashtë, por pa mënjeluar nevojën që studentët të kenë përvojën direkte me nxënës në shkollë dhe me jetën e shkollës në përgjithësi.

Zhvillimi i shkencës

Strategjia e hulumtimit: Përveç planit strategjik, fakulteti do të zhvillojë edhe një strategji apo koncept për zhvillimin e hulumtimit në fakultet të edukimit (pjesë të cilit do të integrohen në plan strategjik). Ky dokument do të shërbejë si pikë referimi për projektet e hulumtimit, profilizim të stafit akademik si dhe do të shërbejë edhe si pikë referimi për krijimin dhe funksionalizimin e ekipeve të hulumtimit të parapara në këtë dokument. Po ashtu, ky dokument do të jetë pikë referimi edhe për orientimin e studentëve në caktimin e temave master e sidomos temave për studimet në nivel të doktoratës. Dokumenti do të përmbajë një profil të personelit

akademik duke përfshirë fushën e studimeve në PhD dhe interesit shkencor (fusha e punimeve shkencore në platformat kredibile).

Funksionalizimi i Institutit për Hulumtim dhe Zhvillim (IHZHA): do të funksionalizohet IHZHA duke caktuar stafin operativ dhe duke finalizuar ofertën e programeve që do të ofrojnë IHZHA. Programet ekzistuese që janë vënë në dispozicion për fakultetin nga donatorët e ndryshëm do të jenë pjesë e ofertës, ndërsa në ndërkohë do të zhvillohen edhe programe të tjera. IHZHA do të aplikojë për fonde në programet e BE-s dhe në fondet e MASHT-it dhe komunave për zhvillim profesional të mësimdhënësve. IHZHA do të përditësojë linkun në web faqen e fakultetit dhe do të ofrojë materialet tjera promovuese për shkollat dhe komunat rreth ofertës që ka në dispozicion. Disa nga programet që do të ofrojë IHZHA janë: edukimi inkluziv, menaxhimi i shkollës, mentorimi, mësimdhënia e matematikës, mësimdhënia e shkencës, zbatimi i teknologjisë në mësim dhe mësimi elektronik, mësimi i bazuar në probleme, mësimi i bazuar në projekte, etj.

Në anën tjetër, IHZHA do të ndihmojë Ekipet Hulumtuese që të aplikojnë në fondet e BE-s për shkencë si dhe në fondet e tjera që mund të jenë në dispozicion. Një synim i veçantë do të jetë angazhimi në programet si HORIZON.

Ekipet e hulumtimit: Do të themelohen Ekipet të hulumtimit (Ang: Research clusters) të cilat do të organizohen rreth temave dhe koncepteve të caktuara në fushën e edukimit. Ekipet hulumtuese do të kenë anëtarë nga fushat e ndryshme por që kanë interes në një fushë të caktuar. Për të adresuar disa nga sfidat e deritanishme e barrikadimit të personelit, do të shqyrtohet mundësia e futjes së kësaj strukture në funksion të shqyrtimit dhe miratimit të projekt propozimeve për studimet bachelor dhe master në emër të departamentit, ndërsa departamentet do të bëjnë procedimin formal në këshill të fakultetit. Rëndësi e theksuar do t'i kushtohet fokusimit të temave master dhe aktivitetit hulumtues të personelit në fushat e rëndësishme të edukimit të përgjithshëm dhe të didaktikës lëndore dhe duke mënjanuar praktikën ende evidente të fokusimit në fushë akademike. Ekipet e hulumtimit do të merren edhe me shqyrtimin e sillabuseve në baza kolegjiale nga kolegët e profilit të përafërt.

Konceptet/temat që do të përdoren si fillim për themelimin e ekipeve të hulumtimit janë: mirëqenia e nxënësve, mësimdhënia efektive (e përgjithshme dhe lëndore), zbatimi i teknologjisë në mësim; të qenit mësimdhënës; zhvillimi i shkollës; politikën arsimore, kurrikulat dhe tekstet, inkluzioni dhe diversiteti; vlerësimi i nxënësve dhe vlerësimi në arsim; arsimit, shoqëria dhe vlerat në arsim; tekstet shkollore, etj. Në këto ekipe do të jenë anëtarë personeli akademik që ka interesim për këto koncepte qoftë nga fusha e përgjithshme e edukimit apo edhe nga e perspektiva lëndore. Secili ekip do të ketë një kryesues (në nivel të sekretarit të departamentit).

Publikimi i monografive shkencore: Çdo vit fakulteti do të caktojë temat relevante që do të zhvillohen përmes Ekipeve Hulumtuese dhe do të publikohen nga fakulteti/univeristeti në formë të Monografive. Temat do të caktohen pas konsultës me kolektivin, ndërsa si pika orientuese do

të jenë temat rreth diversitetit dhe inkluzionit, mësimdhënia lëndore, zhvillimi i mësimdhënësve, vlerësimi i nxënësve, mentorimi, sigurimi i cilësisë në përgatitjen e mësimdhënësve të rinj, etj. Së paku një monografi do të propozohet për botim nga botues të njohur në botë si Routledge, SAGE etj.

Përkrahja e personelit në publikime dhe konferenca: Në kuadër të planifikimit të buxhetit të fakultetit dhe projekteve, do të synohet që personeli akademik të ndihmohet në avancimin e publikimeve shkencore (cilësore) dhe të marrë pjesë në konferenca të rëndësishme të fushës së edukimit në Evropë. Konferencat që do të synohen janë pikë së pari ECER (Konferenca Evropiane e Hulumtimeve në Arsim) dhe ATEE (Asociacioni i Shkollimit të Mësimdhënësve në Evropë). Do të identifikohen edhe konferenca të tjera me interes për fushat e ngushta profesionale.

Po ashtu, do të organizohen disa seanca këshilluese për personelin akademik lidhur me cilësinë e revistave në fushën e edukimit dhe procesin e identifikimit të revistave jociësore.

Rritja e cilësisë së temave master: do të bëhet analiza e titujve të temave master të mbrojtura deri tani (nga një mostër) duke identifikuar nivelin e adresimit të problemeve si dhe do të bëhet një analizë e një mostre të temave master karahas kritereve kryesore si shfrytëzimi i literaturës, analiza e të dhënave etj. Në kuadër të kësaj do të realizohen disa seminare brenda departamenteve për të analizuar dhe adresuar realitetin e tanishëm. Po ashtu, do të publikohen në web faqe të fakultetit të gjitha temat e masterit të organizuara sipas programeve.

Procesi aktual i shqyrtimit të projekpropzimeve do të shqyrtohet dhe do të modifikohet për të rritur seriozitetin, cilësinë dhe angazhimin e ekipeve hulumtuese dhe departamenteve në proces të miratimit duke pasur parasysh relevancën e temës së propozuar dhe rigorizitetin shkencor dhe metodologjik.

Po ashtu, do të punohet drejt rritjes së seriozitetit të mbrotjes së temave master duke inkurajuar personelin që të marrë pjesë në mbrojtje të temave, ndërsa shefat e departamenteve dhe prodekanët do të marrin pjesë në mbrojtje të temave sipas një plani të parapërgatitur dhe të dakorduar.

Përgatitja e lansimit të revistës shkencore: fakulteti në vitet në vijim fillon aktivitetetin e lansimit të një reviste në fushën e edukimit në gjuhën angleze e që do të targetonte rajonin dhe më gjerë. Revista do të ketë një bord ndërkomhtar editorial dhe do të botohet nga fakulteti duke synuar indeksimin në platformat kredibile. Tri vitet në vijim do të dedikohen për përgatitjen e botimit të revistës dhe puna në monografitë e parapara në këtë dokument do të shërbejnë në vendosjen e bazës së revistës shkencore.

Zgjedhja e kontributit të dalluar shkencor të vitit: do të vendoset një proces transparent dhe meritator i identifikimit të kontributit të dalluar në shkencë (në fushën e edukimit) për të cilin do të jepen mirënjohje nga fakulteti. Kontributi duhet të vlerësohet në bazë të kritereve të paracaktuara

përmes qasjes konsultative dhe përmes një procesi transparent. Kontribut i dalluar do të konsiderohet një punim i cili lidhet me zhvillimin e arsimit në Kosovë apo ka ndonjë impakt relevant ndërkombëtar në fushën e edukimit (p.sh numri i citimeve, publikimi në revistë me impakt të lartë, etj).

Bashkëpunimi ndërkombëtar

Angazhimi i shtuar në projekte Evropiane: Fakulteti nuk ka qenë mjaftueshëm aktiv në aplikimet në projektet Evropiane deri tani nëse krahasohet me disa fakultete të tjera apo nëse krahasohet me kolegjet private. Andaj, kjo gjendje do të adresohet me veprime konkrete duke përgatitur aplikime në programin Erasmus Plus për këto tema: zhvillimi/trajnimi i mësimdhënësve për arsimin profesional dhe arsimin e përgjithshëm (zhvillimi në karrierë); Zhvillimi i sistemit të vlerave përmes edukimit të mësimdhënësve të rinj (qytetaria, diversiteti, demokracia etj); Zhvillimi i edukimit inkluziv në edukimin e mësimdhënësve, etj).

Po ashtu, fakulteti do të angazhohet intensivisht që të nisë pjesëmarrjen në projektet e tjera të hulumtimit në nivel Evropian si p.sh HORIZON dhe CostAction.

Fakulteti do të eksplorojë gjithashtu edhe programin Jean Monet për aplikim dhe projekti i propozuar do të synojë zhvillimin e identitetit Evropian përmes edukimit të mësimdhënësve në Kosovë.

Avancimi i gjendjes në shkëmbim akademik: fakulteti do të nisë të monitorojë shifrat e shkëmbimit akademik (të studentëve dhe personelit) që ka përmes programit Erasmus Plus, program i cili me kalimin e kohës do të ofrojë mundësi të shtuara për Kosovën e që do të duhen nisma dhe projekte konkrete për të shfrytëzuar mundësitë. Fakulteti do të eksplorojë mundësitë ekzistuese përmes marrëveshjeve që ka Universiteti i Prishtinës, ndërsa do të synohet edhe realizmi i partneriteteve konkrete me fokus Fakultetin e Edukimit. Fakultetet me të cilat synohet të realizohet marrëveshje konkrete të realizueshme janë:

Kroaci: Zagrebi dhe Osjeku; **Sloveni:** Lublana, Maribori dhe Koper; **Austri:** Viena; **Itali:** Roma Tre, LUMSA, Verona dhe Bolonja; **Finlandë:** Jyväskylä, JAMK dhe TAMPERE; **Norvegji:** NTNU Trondheim, Western Norway University of Applied Sciences në Bergen; **Ceki:** Universiteti Masaryk në Brno; **Suedi:** Linnaeus.

Ofrimi i kurseve në gjuhën angleze: Fakulteti i edukimit si dhe Universiteti në përgjithësi ka patur një vështirësi të theksuar në tërheqjen e studentëve nga jashtë në formë të shkëmbimit akademik. Kjo për shkak të mungesës së kurseve në gjuhën angleze. Andaj, do të hartohen një numër kurseve të zgjedhura në nivel Bachelor, Master dhe PhD në mënyrë që shkëmbimi akademik të jetë dykrahësh dhe të rritet profili ndërkombëtar i fakultetit dhe universitetit përmes shkëmbimeve akademike në kuadër të programeve Evropiane.

Avancimi i bashkëpunimit me fakultetet e edukimit në Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoninë e Veriut: bashkëpunimi do të avancohet përmes organizimit të përbashkët të aktiviteteve si

konferenca dhe simpoziume, përmes aplikimit të përbashkët në projekte Evropiane dhe përmes mentorimit të studentëve dhe pjesëmarrjes në komisione sidomos në studimet e doktoratës.

Lidhja me mjedisin dhe kontributi në sistem të arsimit

Pozicioni i fakultetit në sistem të arsimit: fakulteti i edukimit do të hartojë qëndrimet e veta (Ang: Policy Papers) për çështje të caktuara për sistemin e arsimit në Kosovë në këto tema (por nuk do të kufizohet vetëm në këto): Cilësia e mësimdhënies në Kosovë; Cilësia e përgatitjes së mësimdhënësve në Kosovë dhe rruga tutje; Reforma kurrikulare dhe implementimi i saj; Mësimi në distancë; Organizimi i shokollës në Kosovë, Cilësia e teksteve shkollore; Zbatimi i teknologjisë në mësim, etj.

Po ashtu, fakulteti do të luajë rol aktiv në bashkëpunim me ministrinë e arsimit në definimin e një standardi koherent të përgatitjes së mësimdhënësve për të gjitha fakultetet e edukimit (mësuesisë) në Kosovë.

Magazina për mësimdhënës: fakulteti do të nisë publikimin e një magazine (newsletter në anglisht) për mësimdhënësit e shkollave të Kosovës duke adresuar tema me interes për mësimdhënësit. Materialet do të jenë të përkthyer apo të hartuara nga profesorë e asistentë të fakultetit apo edhe bashkëpunëtorë të fakultetit nga universitetet evropiane.

Konferenca vjetore e arsimit dhe simpoziume: fakulteti do të organizojë konferencën vjetore të arsimit e cila do të bëhet konferencë e rregullt dhe do të synojë qasjen rajonale. Konferenca do të ketë fokus të caktuar secilin vit dhe do të lidhet po ashtu edhe me publikimin e monografive dhe botimeve të tjera si libri i konferencave, etj. Po ashtu, do të organizohen edhe simpoziume me tematika të fokusuar në përgatitjen e mësimdhënësve dhe cilësinë e mësimdhënies në Kosovë e që do të synojë të sjellë akterët relevantë në një tryezë për debatim të çështjeve me interes.

Webinaret: fakulteti do të nisë aktivitetin në organizimin e webinarëve të ndryshme me tema të caktuara për audiencat si drejtorë shkollash, mësimdhënës të ndryshëm dhe ekspertë të arsimit (temat caktohen me fokus të theksuar dhe pas analizës së nevojave dhe prioriteteve të fakultetit dhe sistemit të arsimit.

Lidhja me shkollat: fakulteti do të avancojë partneritetin aktual që ka me shkollat duke synuar që ky bashkëpunim të jetë sa më korrekt dhe të shkojë përtej vendosjes së studentëve në praktikë. Do të caktohen një numër shkollash publike (dhe dy shkolla model private) për realizimin e praktikës për studentë, por edhe realizimin e projekteve të ndryshme të hulumtimit dhe aktiviteteve zhvillimore të fakultetit.

III. Aranzhimi i implementimit

Propozimi është që fakulteti të ketë tre prodekanë me këtë ndarje: prodekan për studime bachelor, prodekan për studime master, dhe prodekan për zhvillim, shkencë dhe cilësi. Prodekanit të tretë do t'i caktohet përgjegjësia e menaxhimit të programit të doktoratës, IHZHA, punën e koordinatorit të cilësisë/koordinatorit për zhvillim akademik, dhe koordinatorit të praktikës (pra punës praktike të studentëve në shkollë). Ndërsa përgjegjësitë e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe mirëmbajtjes së web faqes dhe llogarisë në facebook dhe twitter do të i caktohen prodekanëve që kanë profilin që i përshtatet më së shumti. Kjo strukturë do të diskutohet dhe formalizohet me rregullore dhe në të do të përfshihen edhe administrata (shih më lart analizën funksionale dhe ristrukturimin e administratës) dhe këshilli i fakultetit dhe komisioni i studimeve dhe këshilli i studimeve të doktoratës (përbërja e këtyre dy të fundit do të shqyrtohet për të siguruar gjithëpërfshirje të personelit akademik).

Prodekanët e fakultetit duhet të jenë të dëshmuar si studiues të fushës së edukimit (duke përfshirë edhe publikime në fushën e studimeve arsimore), të jenë njohës të gjuhës angleze, dhe mbi të gjitha duhet të demonstrojnë gatishmërinë që përveç punës administrative dhe menaxheriale janë të interesuar edhe në menaxhim të ndryshimit që është reflektuar në këtë program.

Propozohet të jenë tri nivele të strukturave duke përfshirë dekanatin, departamentet dhe ekipet e hulumtimit. Synimi është që departamentet të ikin nga praktikat e deritanishme që takimet mbahen vetëm për miratim të temave të masterit dhe ky ndryshim të ndërlidhet me strukturën e re të propozuar 'Ekipet e hulumtimit' dhe ndërlidhet ngushtë me reformën e administratës. Secilit departament do t'i caktohet numri adekuat i referentëve në proporcion me numrin e studentëve që shërbejnë. Në rast nevojë do të shqyrtohet mundësia e riorganizimit të departamenteve (pas analizës gjithëpërfshirëse) për të siguruar koherencën dhe rritjen e bashkëpunimit kolegjal dhe avancimin e qasjes ndërdisiplinare në studime dhe në punën shkencore. Do të analizohet mundësia e bashkimit të programit fillor dhe parashkollor në një departament në mënyrë që të rriten mundësitë e bashkëpunimit më të madh kolegjal midis personelit.

Ekipet hulumtuese:

1. Mirëqenia e nxënësve	6. Politikat arsimore dhe zhvillimi i shkollës
2. Mësimdhënia efektive	7. Kurrikulat dhe tekstet
3. Didaktika lëndore	8. Inkluzioni dhe diversiteti
4. Zbatimi i teknologjisë në mësim	9. Vlerësimi i nxënësve dhe në arsim
5. Të qenit mësimdhënës	10. Arsimi, shoqëria dhe vlerat në arsim

Shtojca: Struktura organizative e implementimit të programit zhvillimor

